

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata Speciale ridënon Kosovën. Bie akuza për krime kundër njerëzimit, po dënimet jepen maksimale. Thaçi & Krasniqi 25 vite burg, 18 Veseli dhe 13 Selimi
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/dita-e-verdiktit-final-haga-vendos-sot-per-fatin-e-ish-kre-reve-te-u-i514370
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 06:56:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 06:41:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	97e2d867ea1687ed7b891edccd1619f00e565bd39dc32ff438d218b026de90e6
TEKSTI	389977e8723927fdf5e5a54c880631e3a4f2c95e452a6a33ea1ad48b13114028
PAMJA	6503782e85b069c5029e89d72844abda2bce8163f02590027f658571aa7ee08e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d3ad6d99ad78d74d141c10886925d1943de477856145f3e35edc5605be0a453f
E MËPARSHMJA	a26edc8a5e25038d33935df2cabc3d2c1c30bacb4f28b71dea2521bf89d86d90
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d3ad6d99ad78d74d141c10886925d1943de477856145f3e35edc5605be0a453f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

30 MINUTA ME PARE

Haga dënoi Kosovën/ Tensione dhe përplasje jashtë Gjykatës Speciale, familjarët e ish-krerëve të UÇK-së: E papranueshme, do e apelojmë. Rama: Marre

4 ORE ME PARE

Gjykata Speciale ridënon Kosovën. Bie akuza për krime kundër njerëzimit, po dënimet jepen maksimale. Thaçi & Krasniqi 25 vite burg, 18 Veseli dhe 13 Selimi

15 ORE ME PARE

SYTË NGA HAGA/ Nesër shpallet vendimi për ish-krerët e UÇK-së, rrugët mbushen me flamuj e mbishkrime për Thaçin, Veselin, Krasniqin e Selimin: Shpallini të pafajshëm (PAMJET)

17 ORE ME PARE

108 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën: Edi Rama jep dorëheqjen

LIVE UPDATES

Gjykata Speciale ridënon Kosovën. Bie akuza për krime kundër njerëzimit, po dënimet jepen maksimale. Thaçi & Krasniqi 25 vite burg, 18 Veseli dhe 13 Selimi

• Dhomat e Specializuara në Hagë kanë dënuar me 81 vite burg në total katër ish-krerët e UÇK-së, pasi i shpallën fajtorë për krime lufte të kryera gjatë luftës në Kosovë. • Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ish-kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, janë dënuar me nga 25 vite burg, ndërsa Kadri Veseli me 18 vite dhe Rexhep Selimi me 13 vite. • Trupi gjykues i shpalli penalisht përgjegjës për vepra që përfshijnë vrasje të paligjshme, torturë, trajtim mizor dhe ndalim të paligjshëm ose arbitrar. • Ndërkohë, gjykata rrëzoi akuzat për krime kundër njerëzimit ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së. • Gjatë shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë, trupi gjykues konstatoi se Prokuroria nuk arriti të vërtetojë ekzistencën e një sulmi të përhapur ose sistematik ndaj popullatës civile, një nga kushtet për cilësimin e veprimeve si krime kundër njerëzimit. • Vendimi është i shkallës së parë dhe mund të apelohej në Gjykatën e Apelit të Specializuar.

26 artikuj për këtë temë.

7 MINUTA ME PARE

DOKUMENTI/ Publikohet vendimi i plotë i dënimit të ish-krerëve të UÇK-së



Ish-krerët e UÇK-së

HAGË- Trupi Gjykues shqiptoi sot vendimin në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Trupi Gjykues konstatoi se të katër të akuzuarit ishin penalisht përgjegjës për krimet e luftës të ndalimit arbitrar kundër 385 personave, trajtimit mizor kundër 49 personave, torturës kundër 303 personave dhe vrasjes së paligjshme kundër 96 personave.

Trupi Gjykues i shpalli të akuzuarit të pafajshëm për krime kundër njerëzimit pasi Prokurori i Specializuar nuk arriti të vërtetojë ekzistencën e një sulmi të përhapur ose sistematik ndaj popullatës civile, një nga kushtet për cilësimin e veprimeve si krime kundër njerëzimit.

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 16 SHTATOR 2026, 12:46

DOKUMENTI/ Publikohet vendimi i plotë i dënimit të ish-krerëve të UÇK-së

vendimet janë bazuar në arsyetimin se ishte kryetari i përfaqësuesve gjyqësorë dhe dëshmuesit një popullatë civile. Gjithashtu të akuzuarit u shpallën të pafajshëm në lidhje me një numër incidentesh krime lufte.

Trupi Gjykses dënoi Hashim Thaçin me 25 vjet burgim, Kadri Veselin me 18 vjet burgim, Rexhep Selimin me 13 vjet burgim dhe Jakup Krasniqin me 25 vjet burgim, duke llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim.

Mëposhtë është vendimi i plotë i Gjykatës Speciale:


1 ORE ME PARE

Jakup Krasniqi shpallet fajtor në Hagë, dënohet me 25 vite burg



Jakup Krasniqi


HAGA- Gjykata në Hagë ka shpallur fajtor Jakup Krasniqin për disa nga akuzat për krime lufte, ndërsa e shpalli të pafajshëm për akuzat për krime kundër njerëzimit. Në lidhje me këto akuza, Krasniqi u dënua me 25 vjet burg, ndërsa gjatë shpalljes së vendimit, trupi gjykses deklaroi se Krasniqi është fajtor për disa episode.



Ata argumentuan se ai është fajtor për arrestim dhe ndalim të paligjshëm të 385 personave, trajtim mizor si krim lufte ndaj 49 personave, torturë si krim lufte ndaj 49 personave dhe vrasje të paligjshme të 96 personave. Në fund, kryesuesi i trupit gjykses i tha Krasniqit se shpallet i pafajshëm për akuzat për krime kundër njerëzimit./Dosja.al

1 ORE ME PARE

Hashim Thaçi shpallet fajtor në Hagë, dënohet me 25 vite burg



"Vendimi i Gjykatës Speciale në Hagë u prit në lot nga qytetarët"/ Reuters: Vendimi u ndoq nga afër edhe Serbi

AKTUALITET 16 SHTATOR 2026, 12:09

"Nuk do të na thyejë"/ Vajza e Jakup Krasniqit reagon pas dënimit me 25 vjet: Padrejtësia më e madhe e këtij shekulli

më të klikuarat



SKANDAL/ Deputetja Zegjine Çausi ishte në dijeni se daja i saj kishte marrë peng dhe përdhunuar të renë. Viktima: Erdhi në shtëpi, tha se do na fus në telashe

Rishfaqet "diMAL", pas mishit të infektuar, drogë në kontejner

"Paga bruto e një magjistari"/ Gafat e njëpasnjëshme të deputetes socialiste: Mos e bëni kaq të madhe, është laps

Gjykata e Lartë e la në burg Erion Veliajn/ Rama: Sërish Tirana pa kokë, askush nuk do t'ia dijë për koston e kryeqytetit

insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?


Moti

Powered by tomorrow



Hashim Thaçi

KOSOVË- Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është shpallur fajtor për krime lufte dhe është dënuar me 25 vjet burgim nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Trupi gjykses e shpalli atë penalisht përgjegjës për krime që përfshijnë vrasje, torturë, trajtim mizor dhe ndalim të paligjshëm, të kryera gjatë luftës në Kosovë.



Trupi gjykses ka shqiptuar dënime të veçanta për veprat për të cilat Hashim Thaçi është shpallur fajtor:

-Pika 3 – Arrestim dhe ndalim arbitrar: për 385 persona, 15 vjet burgim.

-Pika 5 – Trajtim mizor: i kryer ndaj së paku 49 personave, 4 vjet burgim.

-Pika 7 – Torturë: e kryer ndaj së paku 303 personave, 20 vjet burgim dhe

-Pika 9 – Vrasje e paligjshme: e kryer ndaj së paku 96 personave, 23 vjet burgim.

Megjithatë, trupi gjykses ka vendosur një dënim të njësuar prej 25 vjetësh burgim, në të cilin do të llogaritet edhe koha që Thaçi ka kaluar në paraburgim./[Dosja.al](#)

1 ORE ME PARE

Trupi gjykses: Krasniqi ishte anëtar kyç në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal





Jakup Krasniqi

HAGË- Trupi gjykues konstatoi se Jakup Krasniqi dha kontribut thelbësor në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal dhe ishte anëtar kyç në zbatimin e politikës së shënjestrimit të personave të konsideruar kundërshtarë. Sipas gjykatësit Charles Smith, përmes publikimit të komunikatave, deklaratave politike dhe urdhrave, Krasniqi inkurajoi kryerjen e krimeve kundër personave të konsideruar kundërshtarë.

1 ORE ME PARE

"Kishte dijeni për keqtrajtimet dhe vrasjet, por nuk ndërhyri për t'i parandaluar"/ Haga: Selimi inkurajoi dhe mori pjesë në krime!



Rexhep Selimi

HAGA- Trupi gjykues në Gjykatën Speciale në Hagë konstatoi se Rexhep Selimi inkurajoi dhe mori pjesë në kryerjen e krimeve në mënyra të ndryshme. Sipas gjykatësit amerikan Charles Smith, Selimi mori pjesë edhe në arrestimin e 13 personave në Qirez.

Trupi gjykues argumentoi se Selimi kishte rol në shpërndarjen e komunikatave dhe luajti rol thelbësor në zonat operative, por ky rol nuk ishte kriminal. Sipas tyre, Selimi për shkak të përfshirjes së tij në sulmet e paraluftës, ishte plotësisht në dijeni se kjo ishte politika e UÇK-së si dhe emëroi persona besnikë në pozita kyçe. Gjyqatri theksoi se ai kishte dijeni për krimet ndaj kundërshtarëve, ndalimin e paligjshëm dhe keqtrajtimin e tyre.

"Rexhep Selimi ishte themelues i UÇK-së dhe anëtar i Shtabit. Ai kishte rol në shpërndarjen e komunikatave. Pozita e tij zyrtare si inspektor i përgjithshëm i dha më pak pushtet krahasuar me të tjerët. Selimi luajti rol thelbësor në zonat operative, por ky rol nuk ishte kriminal. Megjithatë, ai i inspektoi shpesh këto zona dhe mori raporte të shpeshta për persona të ndryshëm. Për shkak të përfshirjes së tij në sulmet e paraluftës, ai ishte plotësisht në dijeni se kjo ishte politika e UÇK-së. Ai emëroi persona besnikë në pozita kyçe. Shumë prej tyre kryenin krime ose ishin në dijeni të qëllimit të përbashkët. Selimi inkurajoi dhe mori pjesë në krime, në mënyra të ndryshme që përshkruhen në aktgjykim. Ai mori pjesë në arrestimin e 13 parlamentarëve në Qirez dhe ishte i pranishëm në disa vende krimesh të paraqitura në aktakuzë.

Selimi inkurajoi kryerjen e krimeve përmes pjesëmarrjes në luftë, mosmarrjes së veprimeve për parandalimin ose ndëshkimin e krimeve kur merrte raporte, si dhe krijimit të precedentit se krimet ishin të pranueshme, përmes pjesëmarrjes personale në to. Ai kishte dijeni për krimet ndaj kundërshtarëve, ndalimin e paligjshëm dhe keqtrajtimin e tyre. Kur u bë ministër i Rendit, ai ndërhyri për të siguruar lirin e katër anëtarëve të UÇK-së, të cilët ishin ndaluar për krijimin e një qendre të paligjshme ndalimi. Ai nuk siguroi që UÇK-ja të vepronte në përputhje me detyrimet e saj sipas së drejtës humanitare ndërkombëtare. Përkundrazi, toleroi shkelje të rënda të kësaj të drejte", tha gjyqtari./Dosja.al

1 ORE ME PARE

Trupi gjykues: Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e krimeve





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.